



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2973 Prot.

Tiranë, më 25.5. 2021

URDHËR

Nr. 113, datë 25.5.2021

PËR
RIORGANIZIMIN E NJËSISË KRYESORE TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR TË BIZNESIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të pikës 5 të nenit 30, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e njësisë kryesore nga “Fakulteti i Drejtësisë” në “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike”, të Kolegjit Universitar të Biznesit, i përbërë nga njësiti bazë, si më poshtë:
 - a) Departamenti i Drejtësisë;
 - b) Departamenti i Shkencave Politike;
 - c) Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
2. Veprimtaria akademike në njësinë kryesore të riorganizuar “Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike”, në Kolegjin Universitar të Biznesit, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion, në zbatim të këtij urdhri.
4. Kolegji Universitar i Biznesit, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës për këtë njësi kryesore të riorganizuar, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar i Biznesit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

